

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **623-26-6199-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Bek Fluids L.L.C.
NUI	812005678
Adresa	Miradi e Poshtme
Vendi	Fushe Kosove
Kodi postar	12000
Numri Telefonit	049/300700
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	HYSNI JUSAJ
Adresa elektronike	bekfluidsllc@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	07.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit

Tenderi është Publikuar me 29.07.2026

Data e planifikuar për hapjen 07.09.2026 ora 14:00

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

PO ESHTË REFUZUAR

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

BAZA LIGJORE

Kjo ankese mbështetet në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar, në veçanti Nenin 7 – Barazia në trajtim/Mosdiskriminimi dhe

Transparenca, Nenin 51 – Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes dhe Nenin 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale, si dhe në Nenin 25.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1 – Kërkesa joproporcionale dhe kufizuese lidhur me mekanizimin dhe pajisjet

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që Operatori Ekonomik të posedojë apo të sigurojë përmes marrëveshjes së qirasë një numër të konsiderueshëm të mjeteve dhe pajisjeve, duke përcaktuar ndër të tjera:

- 1 kamion kiper me peshë bartëse deri 5 ton;
- 1 kamion me peshë bartëse deri 3 ton;
- 2 kamionë me vinç dhe lift, me peshë bartëse deri 8 ton;
- 1 kamion me lift, me peshë maksimale të ngarkesës së lejuar deri 840 kg;
- 1 ngarkues/pirun me peshë deri 4 ton.

Konsiderojmë se formulimi i këtyre kërkesave, veçanërisht përcaktimi i kapaciteteve maksimale me termin “deri”, nuk është i arsyetuar objektivisht dhe nuk është proporcional me objektin e kontratës.

Në këtë mënyrë, një OE që posedon pajisje me kapacitet më të madh dhe teknikisht të barabartë apo më të avancuar mund të konsiderohet se nuk e plotëson kriterin vetëm për faktin se pajisja e tij tejkalon kufirin maksimal të përcaktuar nga AK.

Për shembull, nuk ekziston arsyetim në DT se përse një kamion me lift me kapacitet mbi 840 kg nuk do të mund ta realizonte furnizimin në mënyrë të barabartë apo edhe më efikase sesa një kamion me kapacitet deri në 840 kg. E njëjta çështje paraqitet edhe te përcaktimi i kamionëve me kapacitete “deri 3 ton”, “deri 5 ton” dhe “deri 8 ton”.

Objekti i kontratës është furnizimi dhe shpërndarja e peletit në Komunën e Rahovecit, me sasi indikative prej 350 tonësh.

Prandaj konsiderojmë se kërkesat për pajisje duhet të përcaktojnë kapacitetin minimal funksional të nevojshëm për realizimin e kontratës, dhe jo kufizime maksimale të cilat mund të eliminojnë operatorë ekonomikë që posedojnë pajisje me kapacitete më të mëdha.

Kjo mënyrë e përcaktimit të kriterit konsiderojmë se është në kundërshtim me Nenin 7 dhe Nenin 51 të LPP-së, si dhe me Nenin 25.6 të Rregullores Nr. 001/2022, pasi mund të kufizojë konkurrencën pa një arsyetim objektiv të lidhur me objektin e kontratës.

KËRKESA E OPERATORIT EKONOMIK

Duke u bazuar në pretendimet ankimore dhe dispozitat ligjore të paraqitura më sipër, kërkojmë nga OSHP që:

1. Ta aprovojë si të bazuar ankesën;
2. Ti rishikojë Kërkesën nr. 5 lidhur me mekanizimin dhe pajisjet, duke eliminuar kufizimet e panevojshme të kapaciteteve maksimale dhe duke përcaktuar kërkesa minimale funksionale, relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës;
3. Ta rishikojë Kërkesën nr. 2 lidhur me minimum 5 punëtorë, duke e përshtatur numrin dhe dokumentacionin e kërkuar me nevojat reale për realizimin e kontratës;
4. Të eliminojë kërkesat që nuk janë objektivisht të nevojshme për realizimin e kontratës dhe të harmonizojë Dosjen e Tenderit me Nenet 7, 51 dhe 69 të LPP-së dhe Nenin 25.6 të Rregullores Nr. 001/2022;

Ta obligoj Ak-ne që të beje korrigjimin/ndryshimin e Dosjes së Tenderit.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2 – Kërkesa joproportionale për minimum 5 punëtorë

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar që OE duhet të angazhojë minimum 5 punëtorë, duke kërkuar për secilin prej tyre emrin, mbiemrin, moshën, profesionin, eksperiencën, pozitën në kompani, përshkrimin e shkurtër të vendit të punës, nënshkrimin, si dhe kontratën e punës apo marrëveshjen për angazhim në këtë projekt.

Konsiderojmë se kërkesa për një numër fiks prej minimum 5 punëtorësh nuk është arsyetuar në raport me natyrën konkrete të kontratës.

Aktiviteti i prokurimit ka për objekt furnizimin dhe shpërndarjen e një malli – peletit – dhe jo realizimin e punëve apo shërbimeve komplekse që domosdoshmërisht do të kërkonin një numër të caktuar të personelit profesional.

Në Dosjen e Tenderit nuk është dhënë arsyetim se cilat funksione specifike duhet t'i kryejnë këta pesë punëtorë dhe përse realizimi i kontratës nuk mund të kryhet nga një OE

që posedon kapacitetet e nevojshme teknike dhe logjistike, por e organizon realizimin e furnizimit me një numër tjetër të stafit.

Gjithashtu, nuk rezulton e arsyetuar relevanca e kërkesës për deklarimin e moshës së secilit punëtor në raport me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit për realizimin e furnizimit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se kërkesa e tillë duhet të rishikohet në pajtim me Nenin 51 dhe Nenin 69 të LPP-së, si dhe Nenin 25.6 të Rregullores Nr. 001/2022, në mënyrë që kriteret të kufizohen në kapacitetet që janë realisht të nevojshme dhe proporcionale për realizimin e kontratës.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3 – Kufizimi i konkurrencës dhe mosrespektimi i proporcionalitetit

Konsiderojmë se kombinimi i kërkesës për minimum 5 punëtorë, së bashku me kërkesën për një numër të konsiderueshëm të mjeteve dhe pajisjeve me kapacitete specifike, krijon kërkesa kualifikuese të cilat nuk janë arsyetuar mjaftueshëm në raport me natyrën e kontratës.

Sipas Neni 7 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues nuk duhet të zhvillojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në mënyrë që redukton ose eliminon konkurrencën dhe nuk duhet të përcaktojë kriteret e përzgjedhjes në mënyrë diskriminuese.

Po ashtu, Neni 51 i LPP-së dhe Neni 25.6 i Rregullores Nr. 001/2022 kërkojnë që kriteret të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Për këtë arsye konsiderojmë se kriteret e kontestuara duhet të rishikohen dhe të përcaktohen vetëm në nivelin e domosdoshëm për të siguruar aftësinë e OE-së për realizimin e kontratës, pa krijuar kufizime të panevojshme të konkurrencës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vendimi i AK-së dhe vazhdimi i procedurës me kriteret e kontestuara i shkakton BEK FLUIDS LLC dëm të drejtpërdrejtë, duke i kufizuar mundësinë për konkurrim të barabartë dhe duke krijuar rrezik për eliminim nga procedura për shkak të kriterëve të kontestuara, si dhe humbjen e mundësisë për fitimin e kontratës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.